

**Njoftim për përqendrim me të cilin Allvin International AG, Zvicër, do të fitojë kontroll mbi Logfleks MT Holding Limited (Maltë)
(Lënda nr. 08-48/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24), më datë 26.02.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin Allvin International AG, me seli të regjistruar në adresën Muhlenplac 9, 6004, Lucern, Kanton Lucern, Zvicër, fiton kontroll të pavarur mbi Logfleks MT Holding Limited (Logflex MT Holding Limited), me seli të regjistruar në adresën Ndërtesa MVH, Zyra nr. 1, rruga Oratori, Naksar, NKSR 2504, Maltë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Allvin International AG është një shoqëri e varur 100% e Allvin AG (Allwyn AG), një shoqëri holding e themeluar në Zvicër, e cila fiton dhe menaxhon pjesë në kompani nga industria e lojërave dhe është shoqëria mëmë e Grupit Allvin (Allwyn Group)

Grupi Allvin është një operator ndërkombëtar i lotarisë me prani të konsiderueshme në Austri, Republikën Çeke, Greqi, Qipro, Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Illinois) dhe është në pronësi përfundimtare të Grupit KKCG (KKCG Group).

Grupi KKCG investon në disa fusha biznesi, përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, pasuritë e paluajtshme dhe teknologjinë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e terminaleve për videolotari dhe tregun e teknologjisë së informacionit dhe ka këto shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut:

- KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAQEDONIA SHPK Shkup, me aktivitet primar: veprimtari të lojërave të fatit dhe basteve;
- Lotaria Shtetërore e Videolotarisë së Republikës së Maqedonisë – Kasinos Austria SHPK Shkup, me aktivitet primar: veprimtari të lojërave të fatit dhe basteve;
- KINSHIFT SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm Seavus SHPK Shkup), me aktivitet primar: programim kompjuterik;
- KINSHIFT AKADEMI SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm Seavus Qendra Edukative dhe Zhvillimore SHPK Shkup);
- MUSALA SOFT SHPKNJP Shkup, me aktivitet primar: programim kompjuterik.

Logfleks MT Holding Limited është aktiv në fushën e basteve sportive online dhe kazinove online.

Logfleks MT Holding Limited nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut dhe në asnjë mënyrë nuk është i pranishëm në tregun e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu përkatës për këtë përqendrim mund të definohet si tregu i lojërave të fatit online në Maqedoninë e Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se ky përqendrim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

10.03.2025

Shkup